



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

[www.qbz.gov.al](http://www.qbz.gov.al)

**Nr. 73**

**9 maj**

**2013**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr. 8122 datë 26.4.2013	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	3159
Dekret nr. 8126 datë 29.4.2013	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3159
Vendim i KM nr. 347, datë 24.4.2013	Për autorizimin e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për dhënien e së drejtës së servitutit të vendosjes së gypave për kalimin e ujërave në favor të shoqërisë “Tirana Business Park” sh.p.k.....	3160
Vendim i KM nr. 348, datë 24.4.2013	Për një shtesë në vendimin nr. 315, datë 23.3.2011 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe mënyrën e realizimit të procesit të akreditimit të institucioneve shëndetësore”, të ndryshuar.....	3160
Vendim i KM nr. 349, datë 24.4.2013	Për emërim në detyrë.....	3161
Vendim i KM nr. 351, datë 20.3.2013	Për autorizimin e “Etna Polimer” sh.p.k., për importin e mbetjeve të plastikës për qëllime riciklimi.....	3161
Vendim i KM nr. 352, datë 3.4.2013	Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Arsimit.....	3162
Vendim i KM nr. 353, datë 24.4.2013	Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkesve të papunë të rinj.....	3165

Vendim i KM nr. 354, datë 24.4.2013	Për një shtesë në vendimin nr. 781, datë 14.11.2007 të Këshillit të Ministrave “Për karakteristikat teknike funksionale të pajisjeve fiskale, sistemit të integruar të kompjuterizuar për transferimet periodike automatike të deklarimeve financiare, sistemin e komunikimit, procedurën e dokumentacionit për miratimin e tyre dhe për kriteret për pajisje me autorizim për shoqëritë e autorizuara për ofrimin e pajisjeve fiskale”, të ndryshuar.....	3167
Vendim i KM nr. 355, datë 24.4.2013	Për një ndryshim në vendimin nr. 934, datë 26.12.2012 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2013, në njësitë e qeverisjes qendrore”.....	3168
Vendim i KM nr. 356, datë 24.4.2013	Për një shtesë dhe një ndryshim në vendimin nr. 933, datë 17.11.2010 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave të shqyrtimit administrativ të kërkesave dhe masës së dëmshpërblimit financiar për familjarët e viktimave të ekzekutuara padrejtësisht, pa gjyq, për motive politike, gjatë periudhës 30.11.1944 deri më 1.10.1991”, të ndryshuar.....	3170
Vendim i KM nr.357, datë 24.4.2013	Për miratimin e rregullores “Për menaxhimin e dokumentit elektronik në Republikën e Shqipërisë”.....	3170
Vendim i KM nr. 358, datë 24.4.2013	Për mënyrën e prokurimit të mallrave, punëve e të shërbimeve, në kuadër të veprimtarive të ceremonialit zyrtar.....	3176
Vendim i KM nr. 360, datë 24.4.2013	Për një ndryshim në vendimin nr. 170, datë 25.4.2002 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar.....	3176
Vendim i KM nr. 362, datë 24.4.2013	Për përcaktimin e autoriteteve kontraktuese, përkatësisht, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, për dhënien me koncesion të menaxhimit të mbetjeve të automjeteve në fund të jetës dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë “Kurum Internacional”.....	3177
Vendim i GJK nr. 20, datë 29.4.2013	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, brenda një afati të arsyeshëm.....	3178
Vendim i GJK nr.21, datë 29.4.2013	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr. 2476, datë 14.5.2009 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë; të vendimeve gjyqësore: nr. 1403, datë 3.12.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 530, datë 30.6.2010 të Gjykatës së Apelit Tirane; nr. 937, datë 29.10.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).....	3184

**DEKRET**  
**Nr. 8122, datë 26.4.2013**

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm

**DEKRETOJ:**

**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- |   |   |
|---|---|
| 1. Marsida Kujtim Hiller (Siti Miftari) | 17. Kordelia Qamuran Haberkorn (Kaduku) |
| 2. Renata Jonuz Kokonozi (Abazi)        | 18. Kazim Bektash Hallaç (Hallac)       |
| 3. Kreshnik Ejup Shabani                | 19. Ina Bujar Schanzmann (Mançe)        |
| 4. Nora Ejup Shabani                    | 20. Patricia Gëzim Gjonaj               |
| 5. Arjan Osman Beluli                   | 21. Enxhi Genci Ferhati                 |
| 6. Elona Arjan Beluli                   | 22. Engjëllushe Adem Plesati (Binjaku)  |
| 7. Albana Skënder Beluli (Seiti)        | 23. Ermira Leonard Fekeçi               |
| 8. Kevin Arjan Beluli                   | 24. Louis Eugen Arapi                   |
| 9. Elsa Muhamet Islamaj                 | 25. Klarita Lefter Cipa-Schäfer (Cipa)  |
| 10. Mimoza Islam Duro                   | 26. Kevi Aleksandër Malo                |
| 11. Luan Barjam Lila                    | 27. Afrim Sali Salomon (Leka)           |
| 12. Qani Nexhip Këmbora                 | 28. Olti Jani Pjetri                    |
| 13. Oltion Shenasi Zaçaj                | 29. Maria Leonidha Kapolos (Piperi)     |
| 14. Enton Murat Dauti                   | 30. Lindita Telat Agolli                |
| 15. Marketin Llesh Topallaj             | 31. Artan Et’hem Çuka                   |
| 16. Gjergji Aleko Kuqi                  |   |

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**Bujar Nishani**

**DEKRET**  
**Nr. 8126, datë 29.4.2013**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 9, 10 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm



DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Alban Shuquri Nimani
2. Mynyre Ferat Mulgeci (Luzha)
3. Burim Bafti Memaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
**Bujar Nishani**

**VENDIM**  
**Nr. 347, datë 24.4.2013**

**PËR AUTORIZIMIN E MINISTRISË SË BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË  
KONSUMATORIT PËR DHËNIEN E SË DREJTËS SË SERVITUTIT TË VENDOSJES SË  
GYPAVE PËR KALIMIN E UJËRAVE NË FAVOR TË SHOQËRISË “TIRANA BUSINESS  
PARK” SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 265 e 280 të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” dhe të neneve 4, 10 e 11 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Autorizimin e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për dhënien e së drejtës së servitutit të vendosjes së gypave për kalimin e ujërave në favor të shoqërisë “Tirana Business Park” sh.p.k., mbi pasuritë e paluajtshme, pronë shtetërore, me numër 63 dhe 218, të zonës kadastrale 1669, Fushë-Prezë, Tiranë, si dhe nënshkrimin e marrëveshjes për këtë qëllim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr. 348, datë 24.4.2013**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 315, DATË 23.3.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
“PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE MËNYRËN E REALIZIMIT TË PROCESIT TË  
AKREDITIMIT TË INSTITUCIONEVE SHËNDETËSORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 26 të ligjit nr. 10 107, datë 30.3.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 3 të nenit 21 të rregullores “Për përcaktimin e rregullave dhe mënyrën e realizimit të procesit të akreditimit të institucioneve shëndetësore”, që i bashkëlidhet vendimit nr. 315, datë 23.3.2011 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 4 si më poshtë vijon:

“4. Të ardhurat dytësore të realizuara nga aplikimi i tarifave të procesit të akreditimit, që derdhen për llogari të Qendrës Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore, klasifikohen si të ardhura jashtë limitit (kapitulli 6). Kriteret dhe mënyra e përdorimit të tyre përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Shëndetësisë dhe Ministrit të Financave.”.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave dhe Qendra Kombëtare e Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 349, datë 24.4.2013

**PËR EMËRIM NË DETYRË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Kreshnik Çollaku emërohet Zëvendësministër i Punëve të Jashtme.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 351, datë 20.3.2013

**PËR AUTORIZIMIN E “ETNA POLIMER” SHPK, PËR IMPORTIN E MBETJEVE TË PLASTIKËS PËR QËLLIME RICIKLIMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të pikës 3 të nenit 22 të ligjit nr. 8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar dhe të pikës 2 të nenit 49 të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e “Etna Polimer” sh.p.k., për importin e mbetjeve të polietilenit me kodin tarifor GH 011ex 391510 dhe B1-B3010 të Konventës së Bazelit, aneksi 1 “Mbetjet e listës së gjelbër”, referuar vendimit nr. 825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen, për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi”, të ndryshuar.



2. Sasia e mbetjeve të plastikës, që do të importohet sipas kodeve të referuara në pikën 1 të këtij vendimi, është 4 500 (katër mijë e pesëqind) tonë në vit.

Mbetjet do të importohen nga Kosova, Maqedonia dhe vendet e Bashkimit Europian. Transporti do të bëhet në rrugë tokësore dhe detare, duke plotësuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor për transportin ndërkombëtar të mbetjeve, si dhe kërkesat e kreut II të vendimit nr. 806, datë 4.12.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave dhe procedurave për importimin e mbetjeve për qëllime përdorimi, përpunimi dhe riciklimi”. Ambalazhimi i tyre do të bëhet në paleta, i presuar ose në thasë plastike, sipas kërkesës së dhënë në anekset III dhe IV të vendimit nr. 825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen, për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi”, të ndryshuar.

3. Për çdo transfertë ndërkufitare të mbetjeve, “Etna Polimer” sh.p.k., dorëzon të plotësuar në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, dokumentin e lëvizjes/transfertës ndërkufitare të mbetjeve, sipas formatit të dhënë në anekset III dhe IV të vendimit nr. 825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar. Monitorimi i tyre do të kryhet nga strukturat përkatëse të doganave. Çdo transfertë mbetjesh duhet të jetë e pajisur me raport-analizë, të kryer për aspektin e radioaktivitetit.

4. Periudha e lejitimit të importit të mbetjeve të plastikës nga “Etna Polimer” sh.p.k., është 1-vjeçare, nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

5. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në zbatim të kërkesave të mësipërme ligjore dhe për të siguruar mbrojtjen e mjedisit e të shëndetit publik, merr masat e nevojshme për kontrollin e procesit të riciklimit të mbetjeve të plastikës nga “Etna Polimer” sh.p.k., edhe pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

6. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave komunikon me shkrim me shtetet eksportuese dhe ato tranzitore për autorizimet përkatëse, që lejojnë kalimin e kësaj sasive të mbetjeve të plastikës, në përmbushje të kërkesave të Konventës së Bazelit “Për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre”, në të cilën Republika e Shqipërisë është palë.

7. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr. 352, datë 3.4.2013**

**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSPEKTORATIT SHTETËROR TË ARSIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 11, 51 e 56 të ligjit nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 27 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

**I. KRIJIMI I INSPEKTORATIT SHTETËROR TË ARSIMIT**

Krijohet Inspektorati Shtetëror i Arsimit (ISHA), si institucion qendror, buxhetor, në varësi të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

## II. MISIONI, FUNKSIONET DHE ORGANIZIMI I ISHA-SË

1. ISHA-ja ka për mision përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor në arsimin parauniversitar, si dhe inspektimin e zbatimit të kërkesave ligjore në arsimin parauniversitar dhe të lartë.

2. ISHA-ja kryen këto funksione kryesore:

- a) planifikon dhe bashkërendon veprimtarinë e inspektimit në arsim;
- b) siguron unifikimin e praktikave të inspektimit në shkallë vendi;
- c) jep mbështetje teknike dhe administrative për veprimtarinë e inspektimit;
- ç) harton programin dhe raportin vjetor të inspektimit;
- d) informon publikun për veprimtarinë e inspektimit dhe vendimet e marra;
- dh) kryen drejtpërdrejt inspekte.

3. ISHA-ja është përgjegjëse për:

a) Inspektimin e zbatimit të kërkesave ligjore në fushën e arsimit parauniversitar dhe arsimit të lartë;

b) monitorimin, vlerësimin, këshillimin dhe nxjerrjen e përfundimeve për zhvillimin e arsimit parauniversitar;

c) verifikimin e pajtueshmërisë së veprimtarisë së institucioneve të arsimit parauniversitar dhe atij të lartë me aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe udhëzimet e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës;

ç) monitorimin e problemeve që paraqiten në shkollë me tekstet shkollore;

d) monitorimin e zbatimit të dispozitave normative të shkollës, kodit të etikës së mësuesit, punës së bordit të shkollës dhe të organeve demokratike të saj;

dh) inspektimin e zbatimit të rregulloreve të maturës shtetërore dhe provimeve të lirimimit;

e) menaxhimin e burimeve njerëzore, çështjeve ligjore, teknologjinë e informacionit, mirëmbajtjen e shërbimit e tjera mbështetëse;

ë) përgatitjen dhe zbatimin e buxhetit, mbajtjen e kontabilitetit dhe kryerjen e auditimit të brendshëm.

4. Përveç sa parashikohet në pikën 3 të këtij kreu, ISHA-ja ushtron çdo kompetencë tjetër të përcaktuar nga legjislati në fuqi për Inspektoratin Shtetëror, që mbulon fushën e arsimit parauniversitar dhe atij të lartë.

5. ISHA-ja organizohet vetëm në nivel qendror, ushtron veprimtarinë e saj në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe është përgjegjëse për inspektimin në të gjithë vendin.

6. ISHA-ja drejtohet nga kryeinspektori, i cili është titullari i institucionit. Në kuadër të funksioneve dhe detyrave të Inspektoratit Shtetëror të Arsimit, kryeinspektori i ISHA-së ushtron këto kompetenca:

a) përfaqëson ISHA-në në marrëdhënie me të tretët dhe është përgjegjës për organizimin, funksionimin, cilësinë dhe efektivitetin e veprimtarisë së këtij institucioni;

b) emëron dhe liron nga detyra personelin e ISHA-së në varësi të tij, sipas procedurave të legjislatit në fuqi;

c) zbaton dhe administron buxhetin e miratuar të ISHA-së, në përputhje me legjislatin në fuqi dhe përgatit projektbuxhetin për vitin e ardhshëm, të cilin ia përcjell Ministrit të Arsimit dhe Shkencës;

ç) harton dhe nxjerr udhëzues për veprimtarinë e ISHA-së në fushën e inspektimit dhe të hartimit;

d) bashkërendon veprimtarinë e ISHA-së me organet qendrore dhe organet e tjera shtetërore në fushën e inspektimit të arsimit;

dh) siguron zbatimin dhe kontrollin e zbatimit të akteve ligjore e nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë në fushën e inspektimit të arsimit;

e) siguron kontakte me organe homologe dhe organizata të ndryshme, të huaja, për zgjidhjen efektive të problemeve në fushën e inspektimit të arsimit, si dhe veprimtari të tjera për plotësimin e detyrave, të përcaktuara në legjislatin në fuqi për inspektimin në arsim.

7. Përveç sa parashikohet në pikën 6 të këtij kreu, kryeinspektori:

a) Lëshon autorizimin e inspektimit, në përputhje dhe në bazë të programit të miratuar të inspektimit;



- b) vendos për shtyrjen e kohëzgjatjes së autorizimit, sipas ligjit;
- c) vendos për zëvendësimin e inspektorëve, gjatë inspektimit sipas ligjit;
- ç) shqyrton ankimin e veçantë ndaj vendimeve për masat urgjente të marra nga inspektorët përkatës.

8. Kryeinspektori i ISHA-së i raporton drejtpërdrejt Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, përveç rasteve kur ministri ka përcaktuar shprehimisht, me urdhër, një njësi tjetër raportimi në aparatën e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

9. Pranë ISHA-së krijohet “Komisioni i shqyrtimit të ankimeve”, i cili drejtohet nga kryeinspektori dhe ka në përbërje të tij:

- a) një përfaqësues të njësisë që mbulon çështjet juridike;
- b) një përfaqësues që mbulon çështjet e metodologjisë së inspektimit;
- c) dy specialistë të tjerë të ISHA-së.

10. Lista emërore e komisionit të përmendur në pikën 9 të këtij kreu, miratohet me urdhër të kryeinspektorit dhe bëhet publike me mjete të përshtatshme.

### III. STEMA DHE VULA ZYRTARE E ISHA-së

1. ISHA-ja identifikohet me stemën dhe vulën zyrtare.

2. Stema e ISHA-së përbëhet nga stema e republikës dhe shënimet: “Republika e Shqipërisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Inspektorati Shtetëror i Arsimit”.

3. Vula e ISHA-së ka formën dhe elementet e përcaktuara në pikën 2 të vendimit nr. 390, datë 6.8.1993 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare”, të ndryshuar. Vula e ISHA-së përmban dhe shënimin identifikues “Inspektorati Shtetëror i Arsimit”.

4. Vula e ISHA-së prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### IV. DISPOZITA TRANSITORE DHE TË FUNDIT

1. Ngarkohet Ministri i Arsimit dhe Shkencës që, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të marrë masat për realizimin e emërimit të kryeinspektorit të ISHA-së dhe përgatitjen e strukturës e të organikës së këtij inspektorati.

2. Kryeinspektori i ISHA-së, mbështetur nga njësitë përgjegjëse për burimet njerëzore të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe në përputhje me kërkesat specifike për arsimin e inspektorëve, të miratuara nga Inspektorati Qendror, miraton kërkesat specifike për çdo vend pune.

3. Marrëdhëniet e punës së ISHA-së rregullohen në bazë të dispozitave të parashikuara në legjislacionin për nëpunësit civilë për institucionet e pavarura.

4. Buxheti i planifikuar për Inspektoratin Kombëtar të Arsimit Parauniversitar, si dhe të gjitha asetet dhe detyrimet e tij i kalojnë ISHA-së.

5. ISHA-ja fillon punën, sipas organizimit dhe funksionimit të përcaktuar në këtë vendim, nga data e emërimit të kryeinspektorit dhe të miratimit të urdhrit përkatës të Kryeministrit për miratimin e strukturës dhe të organikës së Inspektoratit Shtetëror të Arsimit, sipas legjislacionit në fuqi, për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

6. Vendimi nr. 56, datë 3.2.2010 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Inspektoratit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar”, si dhe çdo akt tjetër nënligjor, që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohet.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Inspektorati Qendror për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**



**VENDIM**  
**Nr. 353, datë 24.4.2013**

**PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT TË PUNËKËRKUESVE TË PAPUNË TË RINJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr. 7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Punëdhënësit në sektorin privat, të cilët punësojnë të rinj nga mosha 16 - 30 vjeç, që kanë përfunduar arsimin e lartë, arsimin e mesëm të përgjithshëm e profesional dhe kurse të formimit profesional, mund të përfitojnë një financim mujor për tre vjet, në masën 100 për qind të sigurimeve të detyrueshme, shoqërore dhe shëndetësore, të pjesës së kontributit të punëdhënësit, me kusht që në kontratën e punës të jetë tre vjet kohëzgjatja e programit dhe tre vjet të tjerë pa shkëputje pas përfundimit të programit.

Punëdhënësit mund të punësojnë nëpërmjet këtij programi deri në 50% të numrit mesatar të të siguruarve të deklaruar në 3 (tre) muajt e fundit.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, drejtoritë rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe zyrat vendore të punësimit bëjnë njoftimin në Buletinin e Njoftimeve Publike, çdo vit, për fondin e vënë në dispozicion dhe kriteret e përfitimit nga ky program.

3. Punëdhënësi që aplikon për programin e punësimit, nuk duhet të ketë shkelur në të kaluarën legjislacionin e punës, konstatuar nga Inspektorati i Punës dhe nga administrata tatimore, si dhe duhet të ketë derdhur, rregullisht detyrimet tatimore e kontributet për sigurimet e detyrueshme, shoqërore dhe shëndetësore, veçanërisht për vitin e fundit.

4. Punëdhënësit, për përfitimin e sipërpërmendur, aplikojnë pranë zyrave përkatëse të punësimit duke paraqitur dokumentet e mëposhtme:

a) vendimin e gjykatës për regjistrimin si person juridik ose vendimin e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit;

b) numrin e identifikimit të personit të tatuashëm (NIPT-in);

c) vërtetimin për shlyerjen e kontributeve për sigurimet e detyrueshme, shoqërore dhe shëndetësore, që lëshohen nga organet e sigurimeve shoqërore, për aq kohë sa ushtron veprimtarinë, por jo më gjatë se për një periudhë kohore njëvjeçare, nga çasti i aplikimit;

ç) numrin e llogarisë bankare;

d) vërtetimin nga dega e tatim-taksave, ku personi juridik ushtron veprimtarinë, për shlyerjen e detyrimeve tatimore për aq kohë sa kryen veprimtarinë, por jo më gjatë se për një periudhë kohore njëvjeçare, nga çasti i aplikimit;

dh) informacion për:

i) numrin e fuqisë punëtore;

ii) listën emërore të të siguruarve;

iii) llojin e veprimtarisë që kryen;

iv) nivelin e pagës së dhënë për çdo person;

v) planbiznesin për shtimin e fuqisë punëtore;

vi) kopje të akteve të inspektimeve për vitin e fundit.

5. Punëdhënësi, në bashkëpunim me zyrën përkatëse të punësimit dhe në mbështetje të të dhënave e të dokumentacionit të përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi, plotëson formularin përkatës, sipas modelit të miratuar nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

6. Inspektorati Rajonal i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore bën verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti, sipas kërkesave të përcaktuara në shkronjën “dh” të pikës 4 të këtij vendimi dhe shprehet brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike për vërtetësinë dhe korrektësinë e këtij dokumentacioni.



7. Zyra përkatëse e punësimit ia paraqet këshillit vendor trepalësh, të ngritur pranë saj, projektet që kërkohen të zbatohen aty ku ajo ushtron veprimtarinë, këshill, i cili, pasi shqyrton dhe vlerëson dobinë social-ekonomike të projekteve të paraqitura, i miraton ato në parim.

8. Pas miratimit, në parim, të projekteve në këshillin vendor trepalësh, zyra përkatëse e punësimit i dërgon, për miratim, si më poshtë vijon:

a) zyra vendore e punësimit, sipas rastit, ia dërgon zyrës rajonale të punësimit ose Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit;

b) zyra rajonale e punësimit, miraton projektet, kur numri i të punësuarve dhe atyre që kërkohen për t'u punësuar nga punëdhënësi, është jo më shumë se 50 (pesëdhjetë) persona;

c) Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit miraton projektet kur numri i të punësuarve dhe atyre që kërkohen për t'u punësuar nga punëdhënësi, është më shumë se 50 (pesëdhjetë) persona.

9. Për zbatimin e pikës 8 të këtij vendimi, në zyrat rajonale të punësimit dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit ngrihen komisionet e miratimit të projekteve, me jo më pak se 5 (pesë) persona.

10. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të punës, si dhe përbërja e komisioneve përcaktohen në rregulloren e miratuar nga Këshilli Administrativ Trepalësh i Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

11. Komisioni i miratimit të projekteve në zyrën rajonale të punësimit, brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së kërkesës për aplikim nga punëdhënësi, vendos miratimin ose jo të projektit. Komisioni i miratimit të projekteve në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit vendos miratimin ose jo të projektit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së kërkesës për aplikim nga punëdhënësi.

12. Zyra e punësimit vë në dispozicion të punëdhënësve listën e punëkërkuësve të papunë që plotësojnë kriteret për të përfutur nga ky program. Punëdhënësi përzgjedh kandidatin më të përshtatshëm.

13. Punëkërkuësit e papunë, që kundërshtojnë të marrin pjesë në këtë program, hiqen nga lista e punëkërkuësve të papunë.

14. Ndërmjet zyrave përkatëse të punësimit dhe të punëdhënësit nënshkruhet një kontratë, ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet, në përputhje me programin për secilën palë. Kontratat lidhen vetëm për vitin buxhetor, për të cilin është miratuar projekti.

15. Për vazhdimin e projektit në vitin pasardhës do të lidhet një kontratë shtesë në përputhje me fondet e miratuara atë vit.

16. Punëdhënësi dhe punëkërkuësi, si punëmarrës, nënshkruajnë një kontratë individuale pune, në të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve, sipas përcaktimeve të bëra në Kodin e Punës dhe në këtë vendim.

17. Kontratat tip, sipas përcaktimeve të dhëna në pikat 14 e 16 të këtij vendimi, hartohen nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga zyrat përkatëse të punësimit.

18. Një kopje e kontratës së punës së çdo punëkërkuësi, punëmarrës, depozitohet në zyrën përkatëse të punësimit, e cila, në bashkëpunim me inspektoratin rajonal/vendor të punës, ndjek zbatimin e kontratës deri në përfundimin e projektit.

19. Në rastet kur punëkërkuësi, si punëmarrës, pjesëmarrës në këtë program, largohet përpara afatit të përcaktuar në kontratë brenda gjysmës së vitit të parë të zbatimit të kontratës sipas pikës 16, për shkaqe të arsyeshme, zëvendësimi bëhet nga zyra përkatëse e punësimit, pas njoftimit nga punëdhënësi dhe vlerësimit të Inspektoratit të Punës për shkaqet e zgjidhjes së kontratës.

20. Punëdhënësi, i cili ndërpret marrëdhëniet e punësimit, pa shkaqe të arsyeshme për periudhën mbas përfundimit të subvencionimit (3-vjeçari i dytë), detyrohet të kthejë subvencionin e marrë për këtë person për periudhën e paplotësuar sipas kontratës.

21. Financimi sipas pikës 1 ndërpritet në rastin kur punëdhënësi, pas përfundimit të financimit, në zbatim të këtij vendimi, zgjidh, pa shkaqe të arsyeshme, kontratat e punës së punëmarrësve të tjerë, të punësuar pranë tij, të vërtetuar nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale.

22. Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore, nënshkruajnë një marrëveshje bashkëpunimi për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim.

23. Shërbimi Kombëtar i Punësimit monitoron ecurinë e programit dhe përgatit raporte vjetore, brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, të cilat ia paraqet Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

24. Programi i punësimit të fillojë të zbatohet në vitin 2013 dhe kohëzgjatja e tij të jetë 6 (gjashtë) vjet.

25. Shërbimi Kombëtar i Punësimit ruan dokumentacionin për programin e punësimit deri në 10 (dhjetë) vjet, pas dhënies së fundit të ndihmës individuale.

26. Programi vlerësohet nga ekspertë ose organizata të pavarura, që kanë përvojë në këtë fushë dhe njohuri për tregun e punës.

27. Fondet për zbatimin e këtij programi përballohen nga buxheti i Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

28. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministria e Financave për nxjerrjen e udhëzimeve për zbatimin dhe mbikëqyrjen e programit dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit për zbatimin e programit, nëpërmjet zyrave të punësimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr. 354, datë 24.4.2013**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 781, DATË 14.11.2007 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR KARAKTERISTIKAT TEKNIKE FUNKSIONALE TË PAJISJEVE  
FISKALE, SISTEMIT TË INTEGRUAR TË KOMPJUTERIZUAR PËR TRANSFERIMET  
PERIODIKE AUTOMATIKE TË DEKLARIMEVE FINANCIARE, SISTEMIN E  
KOMUNIKIMIT, PROCEDURËN E DOKUMENTACIONIT PËR MIRATIMIN E TYRE DHE  
PËR KRITERET PËR PAJISJE ME AUTORIZIM PËR SHOQËRITË E AUTORIZUARA PËR  
OFRIMIN E PAJISJEVE FISKALE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 55 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në fund të shkronjës “ç” të pikës 2 të kreut III “Dispozita transitorë dhe të fundit”, të vendimit nr. 781, datë 14.11.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Për biletat e Lotarisë Kombëtare, të miratuara nga Ministri i Financave, kompania e licencuar për ushtrimin e Lotarisë Kombëtare me ligjin nr. 95/2013 “Për miratimin e marrëveshjes së licencës për Lotarinë Kombëtare ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoritet i autorizuar dhe shoqërisë “Oesterreinische Lotterien”, GmbH, nëpërmjet shoqërisë “OLG Project” sh.p.k., nuk është e detyruar të instalojë e të përdorë pajisje fiskale. Biletat e Lotarisë Kombëtare janë kupon fiskal.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha



**VENDIM**  
**Nr. 355, datë 24.4.2013**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 934, DATË 26.12.2012 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË  
PËRKOHSHME, PËR VITIN 2013, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 pika 2 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 11 të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Pika 1 e vendimit nr. 934, datë 26.12.2012 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2013, në njësitë e qeverisjes qendrore bëhet 975 veta. Shtesa prej 27 punonjësish është e detajuar sipas lidhjes nr. 5 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”

2. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi përballohen nga shpenzimet korente të miratuara në buxhetin përkatës të institucionit për vitin 2013.

3. Ngarkohen ministritë dhe institucionet buxhetore sipas lidhjes nr. 5, të përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, të depozitojnë pranë Ministrisë së Financave detajimin e numrit të punonjësve brenda kritereve të vendimit nr. 1703, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe aktiviteteve sezonale/të përkohshme, për ministritë dhe institucionet buxhetore”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Lidhja nr.5

Emri i Institucionit	Nr. Punonjës	Emertesa	Koha mesatare ditore (deri ne...)	Periudhe kohore
<b>Ministria e Turizmit, Kulture, Rinise dhe Sporteve</b>	<b>17</b>			
ZAKP Butrint	5	Ciceron (Vezhgues)	8 ore/dite	Maj - Tetor
ZAKP Butrint	2	Punctor miremb.	8 ore/dite	Maj - Tetor
ZAKP Butrint	1	Biletashites	8 ore/dite	Maj - Tetor
Muzeu Kombetar i Artit				
Mesjetar Korce	3	Restaurator	8 ore/dite	Maj - Tetor
Cirku Kombetar	1	Veteriner	3 ore/dite	Prill - Dhjetor
Cirku Kombetar	1	Koreograf	5 ore/dite	Prill - Dhjetor
Cirku Kombetar	1	Sanitar	4 ore /dite	Prill - Dhjetor
Arkivi Qendror i Filimit	1	Sanitar	4 ore /dite	Prill - Dhjetor
Qendra Kulture per Femije	1	Skenograf	6 ore /dite	Prill - Dhjetor
Qendra Kulture per Femije	1	Mjeshter skene	6 ore /dite	Prill - Dhjetor
<b>Ministria e Financave</b>	<b>10</b>			
Agjencia e Administrimit				
Pasurive te Sekuestruara	1	Sanitar	4 ore/dite	Prill - Dhjetor
Aparati I Drejtorise se				
Pergjithshme te Doganave	1	Punctor miremb.	4 ore/dite	Prill - Dhjetor
Dogana Tirane	1	Sanitar	4 ore/dite	Prill - Dhjetor
Dogana Shkoder	1	Punctor miremb.	4 ore/dite	Prill - Dhjetor
Dogana Qafe Thane	1	Punctor miremb.	4 ore/dite	Prill - Dhjetor
Dogana Qafe Thane	1	Sanitar	4 ore/dite	Prill - Dhjetor
Dogana Gjirrokaster	1	Sanitar	4 ore/dite	Prill - Dhjetor
Dogana Vlore	1	Punctor miremb.	4 ore/dite	Prill - Dhjetor
Dogana Elbasan	1	Punctor miremb.	4 ore/dite	Prill - Dhjetor
Dogana Tre Urat	1	Punctor miremb.	4 ore/dite	Prill - Dhjetor
<b>Total punonjes me kontrate</b>	<b>27</b>			



**VENDIM**  
**Nr. 356, datë 24.4.2013**

**PËR NJË SHITESË DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 933, DATË 17.11.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT ADMINISTRATIV TË KËRKESAVE DHE MASËS SË DËMSPËRBLIMIT FINANCIAR PËR FAMILJARËT E VIKTIMAVE TË EKZEKUTUARA PADREJTËSISHT, PA GJYQ, PËR MOTIVE POLITIKE, GJATË PERIUdhËS 30.11.1944 DERI MË 1.10.1991”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit të tretë, të nenit 2 të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007 “Për dëmspërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr. 933, datë 17.11.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet shtesa dhe ndryshimi si më poshtë vijon:

1. Pas shkronjës “c/1” të pikës 6 të shkronjës “A” “Fillimi i shqyrtimit të kërkesave”, shtohet shkronja “c/2”, me këtë përmbajtje:

“c/2. Aktin administrativ të dhënë pas datës 1.10.1991 apo vendimin e gjykatës, që provon faktin e ekzekutimit pa gjyq, për motive politike, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.”.

2. Pika 7 e shkronjës “B” “Shqyrtimi i kërkesës”, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.357, datë 24.4.2013**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR MENAXHIMIN E DOKUMENTIT ELEKTRONIK NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 21 të ligjit nr. 10 273, datë 29.4.2010 “Për dokumentin elektronik” dhe të ligjit nr. 9880, datë 25.2.2008 “Për nënshkrimin elektronik”, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e rregullores “Për menaxhimin e dokumentit elektronik në Republikën e Shqipërisë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen të gjitha njësitë e administratës publike, të cilat do të përdorin dokumentin elektronik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**



**RREGULLORE**  
**PËR MENAXHIMIN E DOKUMENTIT ELEKTRONIK NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**1. Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë rregullat e përgjithshme për përdorimin e dokumentit elektronik, në përputhje me ligjin nr. 10273/2010 “Për dokumentin elektronik”, i cili, duke kursyer kostot kohore dhe financiare, siguron që këto dokumente të jenë të disponueshme, autentike, të aksesueshme gjatë ciklit jetësor të tyre.

**2. Objekti**

2.1 Kjo rregullore përcakton krijimin, dërgimin, marrjen, mbrojtjen, ruajtjen, protokollimin, arkivimin, sipas legjislacionit në fuqi dhe specifikimeve të përcaktuara në këtë rregullore për organet e administratës publike.

2.2 Kjo rregullore zbatohet nga çdo organ i administratës publike, të cilët duhet të krijojnë burime teknologjike, organizative dhe njerëzore që kërkohen për funksionimin e sistemit të menaxhimit të dokumenteve elektronike.

**3. Përkufizime**

3.1 Sistemi i Menaxhimit të Dokumentit Elektronik (SMDE) përfshin tërësinë e mjeteve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) të krijuara në mënyrë specifike për të menaxhuar krijimin, përdorimin, mirëmbajtjen dhe vënien në dispozicion të dokumenteve, me qëllim që të sigurohet evidencë e aktiviteteve institucionale.

3.2 Pajisjet për menaxhimin e dokumentit elektronik janë pajisje teknike që mundësojnë menaxhimin e dokumentit elektronik sipas formateve të përcaktuara në aneksin nr. 1, në bashkëveprim me pajisjet teknike të krijimit të nënshkrimit elektronik, sipas ligjit për nënshkrimin elektronik.

3.3 Volum do të quhet një grup dokumentesh të caktuara, të cilat kanë lidhje ose i përkasin së njëjtës çështje apo teme, të cilat ruhen bashkë.

**4. Organizimi dhe funksionet**

Institucionet publike, sipas kësaj rregulloreje, për përdorimin e dokumentit elektronik, duhet të sigurojnë:

4.1 Përdorimin e një sistemi të menaxhimit të dokumentit elektronik;

4.2 Emërimin e personit përgjegjës/administratorit dhe zëvendësit e tij, të marrin masa për përcaktimin e standardeve në lidhje me krijimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e dokumenteve elektronike nga sistemi.

5. Detyra dhe përgjegjësitë e institucionit mbi menaxhimin e SMDE

Institucioni publik nëpërmjet titullarit apo personave të autorizuar prej tij:

5.1 Aprovon të drejtat e aksesit në SMDE dhe ndryshime të mundshme për një punonjës apo grup punonjësish.

5.2 Miraton masa për të siguruar përmirësimin teknologjik (*upgrade*) e sistemit në një TIK më të avancuar, kur e para nuk është në gjendje të kryejë më funksionet e parashikuara.

5.3 Gjatë përmirësimit teknologjik (*upgrade*) duhet të sigurohet ruajtja e integritetit të të dhënave dhe dokumenteve që ruhen në sistem; si dhe:

a) Periodikisht rishikon dhe rinovon/konverton dokumentet në formatet më të fundit.

b) Rishikon, dhe nëse është e nevojshme, përditëson (*update*) pajisjet teknologjike (*software & hardware*) të përdorura nga sistemi, të cilat mundësojnë funksionet e përcaktuara në pikën 6 të kësaj rregulloreje.

5.4 Përcakton përgjegjësitë strukturore, të detajuara dhe përshkrimet e punës për çdo rol, për mirëfunksionimin e sistemit, si dhe përgjegjësitë mbi aksesin ndaj masave të kontrollit të një dokumenti elektronik, i cili regjistrohët në metadata.



5.5 Miraton masat teknike dhe organizative për të siguruar autenticitetin, integritetin, disponueshmërinë e dokumentit elektronik.

5.6 Përcakton metoda monitorimi nga ana teknike të performancës së SMDE, për të evidentuar mangësitë gjatë procesit të punës në sisteme dhe metoda të tjera për t'i eliminuar ato.

#### 6. Funksionet e SMDE

Sistemi i menaxhimit të dokumentit elektronik, duhet të përmbushë kërkesat funksionale të mbështetura në standardin ndërkombëtar ISO/161 75-2; 2011 duke mundësuar funksionet e mëposhtme:

6.1 Krijimin, dërgimin, marrjen, mbrojtjen, ruajtjen, protokollimin, arkivimin, sipas legjislacionit në fuqi dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në këtë rregullore.

6.2 Identifikimin dhe autentifikimin e përdoruesve.

6.3 Mbrojtjen e informacionit lidhur me secilin përdorues kundrejt të tjerëve.

6.4 Të lejojë gjurmimin e çdo modifikimi të informacionit të trajtuar, të identifikojë autorin e tij si dhe të kryejë regjistrimin e aktivitetit të çdo përdoruesi në mënyrë të tillë që të garantojë sigurinë dhe integritetin e sistemit.

6.5 Të verifikojë dhe të garantojë përputhshmërinë me specifikimet në përputhje me ligjin për dokumentin elektronik.

6.6 Të verifikojë dhe të garantojë përputhshmërinë me specifikimet në përputhje me ligjin për nënshkrimin elektronik, në mënyrë që të mundësojë krijimin dhe verifikimin e një nënshkrimi elektronik të kualifikuar.

6.7 Të sigurojë që një DE hyrës/dalës të regjistrohet vetëm një herë në sistem dhe të sigurojë bashkimin e dokumenteve në grupe dokumentesh të caktuara qartësisht, të cilat kanë lidhje ose i përkasin të njëjtës çështje apo temë, volum.

6.8 Të mbushë automatikisht të dhënat në metadata e DE.

6.9 Të sigurojë metoda për kërkimin në çdo nivel të sistemit, si dhe të gjenerojë rezultatet e këtij kërkimi.

6.10 Gjatë qarkullimit brenda institucionit, duhet të ruhen të gjitha versionet e DE.

6.11 Para dërgimit të dokumentit elektronik SMDE, krijon më parë protokollimin e tij nga sistemi.

6.12 Gjatë transferimit të DE në një sistem tjetër të teknologjisë së informacionit, dokumenti të mos humbasë asnjë të dhënë tjetër plotësuese, përfshirë dhe metadata e nevojshme sipas aneksit nr. 1.

6.13 Të parandalojë fshirjen apo shkatërrimin e paautorizuar ose aksidental të DE.

6.14 Të printojë përmbajtjen e DE dhe metadatave të tyre, informacionin mbi nënshkrimin elektronik, si dhe të dhëna të tjera shtesë të përmbajtur në SMDE.

6.15 Të gjenerojë kopje në letër të dokumentit elektronik, ose një kopje të konvertuar të metadatave, që evidenton të dhënat e krijuesit dhe nënshkruesit të DE, duke përmbajtur titullin (institucioni) dhe pozicionin e nënshkruesit (nëpunësi), emër, mbiemër, datën e krijimit dhe datën e nënshkrimit.

6.16 Të jetë në gjendje të realizojë një procedurë të transferimit të DE, për t'u ruajtur në Arkivin e Shtetit.

6.17 Të vërtetojë ekzistencën e një DE në një kohë të caktuar.

6.18 Të kryejë funksione të tjera sipas specifikimeve të përdoruesit.

6.19 Të mundësojë njohjen e dokumenteve në format audio dhe video.

6.20 Të mundësojë rifutjen e DE dhe të dhënave shoqëruese të tyre, në sistem, nga mediumet e ruajtjes fizike.

6.21 Sistemi i menaxhimit të dokumentit elektronik, duhet të përmbushë detyrimet që burojnë nga ligji nr. 10 325, datë 23.9.2010 "Për bazën e të dhënave shtetërore" dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

6.22 SMDE duhet të pranojë dhe të përpunojë dokumente të formateve sipas specifikimeve të përmendura në aneksin nr. 2.



## KREU II KRIJIMI DHE QARKULLIMI I DOKUMENTIT ELEKTRONIK

### 7. Krijimi dhe përmbajtja e dokumentit elektronik

7.1 Struktura e një DE, bëhet në përputhje me kërkesat dhe specifikimet e ligjit për dokumentin elektronik.

7.2 Institucionet që aplikojnë përdorimin e DE duhet të përmbushin kërkesat dhe kriteret sipas ligjit për dokumentin elektronik dhe kësaj rregulloreje.

7.3 Pasi krijon një DE, krijuesi e nënshkruan atë me nënshkrim elektronik të kualifikuar, sipas ligjit për nënshkrimin elektronik.

7.4 Forma e jashtme e paraqitjes së një DE, duhet të përmbushë të njëjtat kritere si dokumenti shkresor.

7.5 Përpara dërgimit të dokumentit elektronik, duhet të kontrollohet që nënshkrimi elektronik, bashkëngjitur tij, është i vlefshëm dhe i verifikueshëm.

### 8. Marrja dhe përpunimi i dokumentit elektronik

8.1 Një institucion shtetëror, pas marrjes së dokumentit elektronik, e trajton atë në të njëjtat procedura me të cilat trajtohet edhe dokumenti shkresor, i përcaktuar në ligjin “Për arkivat”.

8.2 Gjatë marrjes së një dokumenti në formë shkresore nga një institucion, i cili nuk disponon SMDE, institucioni marrës e kthen atë në formë elektronike dhe e trajton atë në të njëjtën mënyre, si edhe dokumentin elektronik.

8.3 Institucionet, të cilat përdorin SMDE gjatë korrespondencës së tyre me institucione të cilët nuk përdorin një sistem të tillë, pas protokollimit të DE për t’u dërguar, e kthejnë atë në formë shkresore, duke i bashkëngjitur numrin e protokollit.

### 9. Mbrojtja dhe ruajtja e dokumentit elektronik

9.1 Masat e sigurisë të adoptuara dhe të realizuara nga një institucion shtetëror përdorues i SMDE duhet të sigurojnë disponueshmërinë e informacionit të përpunuar dhe të ruajtur në protokollin elektronik, kopjet dhe rivendosjen në gjendjen funksionale në rastet e situatave të jashtëzakonshme.

9.2 Siguria e operimit, aksesit të një protokollit elektronik korrespondon me dokumentet e sigurisë të adoptuara nga institucioni publik dhe bazohet në një rregullore sigurie sipas standardeve ndërkombëtare.

9.3 Masat e sigurisë, konform dokumenteve të sigurisë, duhet të kontrollohen dhe auditohen periodikisht.

9.4 Përgjatë kohës së ruajtjes, duhet të sigurohet që DE dhe metadat bashkëngjitur të jenë të aksesueshme, të lexueshme; dhe nënshkrimi elektronik të jetë i verifikueshëm.

9.5 Periudha kohore e ruajtjes së një dokumenti vendoset nga rëndësia dhe tematika e tij në përputhje me ligjin për arkivat.

9.6 Institucioni duhet të sigurohet që DE dhe të dhënat e lidhura me to të ruhen (*backup*), periodikisht nga pajisja qendrore në medime të tjera fizike, si edhe në një sistem ruajtje elektronik (*backup*), brenda dhe jashtë institucioni, të përcaktuara sipas standardeve ndërkombëtare në rregulloret për SMDE.

9.7 Çdo institucion që përdor SMDE, duhet të ruajë në mënyrë të detyrueshme për një periudhë kohore 10-15 vite, dokumentet edhe në formë shkresore.

### 10. Kopja në letër e dokumentit elektronik

Çdo DE mund të printohet edhe në letër në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 10 të ligjit për dokumentin elektronik.

## KREU III PROTOKOLLI ELEKTRONIK

### 11. Kërkesat minimale të sigurisë së protokollit elektronik

11.1 Protokollin elektronik duhet t’u nënshtrohet të njëjtave procedura standarde, si edhe protokollin i zakonshëm. Ai duhet të mirëmbahet vetëm nga personi i autorizuar.



11.2 Protokollimi/krijimi i një hyrjeje të re në protokollin elektronik, duhet të jetë i mbrojtur nga ndërhyrjet dhe modifikimet e paautorizuara.

12. Protokolli elektronik i DE

12.1 Protokolli elektronik merr DE vetëm nëpërmjet SMDE.

12.2 Protokolli elektronik regjistron DE e marrë në listën/regjistrin e dokumenteve të marra.

12.3 Në momentin e regjistrimit, DE i afishohet një numër serial protokollit, i cili duhet të jetë unik, së bashku me çdo të dhënë tjetër identifikuese.

12.4 Kur një DE nuk vjen nga një SMDE tjetër, por vjen në formë shkresore, pas konvertimit të tij në formë elektronike protokollohet në të njëjtën mënyrë, si dhe DE.

12.5 Procedurat e regjistrimit të dokumenteve hyrëse dhe dalëse, kryhen sipas kriterëve të përcaktuara sipas normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

12.6 DE e marra mblidhen automatikisht nga SMDE dhe futen në një listë të dokumenteve të marra, duke filluar nga më i hershmi, në përputhje me ligjin për arkivat dhe rregulloret e brendshme të institucionit. Pasi aprovohen nga personi përgjegjës, ato kalojnë në një listë të dokumenteve të protokolluara dhe, sipas nevojave specifike të institucionit, mund të printohen ose kalohen për përpunim të mëtejshëm brenda institucionit.

12.7 Në rastin kur DE është dërguar gabimisht, personi përgjegjës e revokon/refuzon atë.

12.8 Në të njëjtën kohë sistemi i transmeton një mesazh revokimi institucionit dërgues.

12.9 Për arsye sigurie, përmbajtja e protokollit elektronik ruhet (*backup*) periodikisht në skedarë të veçantë.

## ANEKSI NR.1

### I. METADATAT E DOKUMENTIT ELEKTRONIK

- 1.1 Emri i personit fizik, dërguesi
  - 1.2 Emri i personit juridik, institucioni dërgues,
  - 1.3 Titulli i dokumentit
  - 1.4 Data e dërgimit të dokumentit
  - 1.5 Numri i protokollit të institucionit dërgues
  - 1.6 Data e marrjes së dokumentit
  - 1.7 Numri i protokollit të marrësit
  - 1.8 Indeksi i "file" të cilit ruhet dokumenti
- Kodi i institucionit (NIPT)  
Emri i institucionit të cilit i dërgohet

### 2. METADATAT E NËNSHKRIMIT ELEKTRONIK

- 2.1 Emri i plotë i personit nënshkrues
  - 2.2 Pozicioni i punës së personit nënshkrues
  - 2.3 Datën dhe orën e krijimit të nënshkrimit
- Qëllimin e nënshkrimit (nënshkrim, aprovim etj.)

### 3. METADATAT E "FILE" ELEKTRONIK

- 3.1 Emrin e institucionit
  - 3.2 Emrin e drejtorisë apo sektorit përkatës, i cili ka krijuar dokumentin ose të atij që i drejtohet
  - 3.3 Indeksën e volumnit, të cilit i përket ky "file"
  - 3.4 Titullin ose nëntitullin e volumnit (nëse ekziston)
  - 3.5 Datën e krijimit të volumnit
  - 3.6 Informacion mbi asgjësimin/shkatërrimin e "file"
- Informacion mbi kohëzgjatjen e ruajtjes së volumnit  
Informacion mbi *backup* të "file"

#### 4. PROCEDURA PËR PËRGATITJEN DHE PLOTËSIMIN E METADATAVE

Personi përgjegjës për plotësimin e metadatave, duhet të vendosë emrin e tij të plotë, datën e plotësimit; emrin e personit përgjegjës për aprovimin e tyre dhe datën e aprovimit; nëse ky i fundin ndryshon nga i pari.

#### 5. METADATAT E MENAXHIMIT TË DOKUMENTIT ELEKTRONIK

5.1 Të dhëna mbi ndryshime që mund të jenë bërë mbi metadatat e dokumentit ose të “file” elektronik.

5.2 Të dhëna mbi aksesin ndaj dokumentit elektronik ose “file” elektronik dhe/ose kufizime të mundshme mbi metadatat ose mbi limitin e ndryshimeve që mund të bëhen në to.

#### 6. METADATAT E RUAJTJES SË “FILE” TË DOKUMENTEVE ELEKTRONIKE

6.1 Të dhëna mbi “backup”-in e dokumentit elektronik (numrin, formatin, vendin e ruajtjes, hapësirën e ruajtjes etj.).

6.2 Të dhëna mbi konvertimin dhe restaurimin e dokumentit nga “*backup*”-i.

#### 7. METADATA TË TJERA OPSIONALE

7.1 Metadata të dokumentit dhe “file”-it elektronik

- a) Formatin e dokumentit elektronik
- b) Të dhëna mbi periudhën e vlefshmërisë së nënshkrimit elektronik
- c) Adresa e institucionit dërgues
- d) Numër kontakti të institucionit dërgues
- e) Llojin e dokumentit (urdhër, udhëzim, memo etj.)

### ANEKSI NR.2

#### 2.1 FORMATET E DOKUMENTEVE ELEKTRONIKE QË DUHET TË NJOHË SMDE

- a) Microsoft/Apple Rich Text Format (RTF) versioni më i fundit sipas Microsoft Corporation.
- b) Adobe Portable Document Format (PDF) versioni më i fundit sipas Adobe Systems Incorporated.
- c) HTML sipas versionit më të fundit nga <http://www.w3c.org>
- d) XML versioni më i fundit, Extensible Markup Language sipas <http://www.w3c.org>
- e) XHTML versioni më i fundit, sipas The Extensible Hyper Text Markup Language
- f) Open Office, org XML File Format, sipas Open Office.org, Technical Reference Manual Microsystems, [http://xml.openoffice.org/xml\\_specification.pdf](http://xml.openoffice.org/xml_specification.pdf).
- g) Secure Hyper Text Transfer Protocol. HTTPS, sipas RFC 2660S-HTTP
- h) Microsoft Office formats (.doc, .docx, .ppt, .pptx etj.)
- i) Çdo lloj formati i “file” që gjykohet e arsyshme.

#### 2.2 STANDARDET E REFERIMIT

- a) ISO 15489 Information and documentation — Records management
- b) ISO 21127 Information and documentation — A reference ontology for the interchange of cultural heritage information
- c) ISO 23950 Information and documentation — Information retrieval (Z39.50) — Application service definition and protocol specification
- d) ISO 10244 Document management — Business process baselining and analysis
- e) ISO 32000 Document management — Portable document format
- f) ISO 2709 Information and documentation — Format for information Exchange
- g) ISO 15836 Information and documentation — The Dublin Core metadata element



**VENDIM**  
**Nr. 358, datë 24.4.2013**

**PËR MËNYRËN E PROKURIMIT TË MALLRAVE, PUNËVE E TË SHËRBIMEVE, NË  
KUADËR TË VEPRIMTARIVE TË CEREMONIALIT ZYRTAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të vendimit nr. 229, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave “Për ceremonialin zyrtar të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të vendimit nr. 1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Institucioni i Presidentit të Republikës, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Kryeministria dhe Ministria e Punëve të Jashtme të prokurorin mallra, punë dhe shërbime, sipas përcaktimeve të ceremonialit zyrtar të Republikës së Shqipërisë dhe të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, në kuadër të organizimit të veprimtarive të veçanta dhe të përditshme, me karakter protokollar dhe ceremonial.

2. Prokurimet për këtë kategori i nënshtrohen procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, sipas dispozitave të legjislacionit për prokurimin publik. Nëse vlera e përlogaritur për artikuj apo grup artikujsh, brenda një viti kalendarik, është nën kufirin e ulët monetar.

Kjo procedurë prokurimi nuk zhvillohet me mjete elektronike.

3. Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, në rastet e organizimit të veprimtarive të veçanta, sipas ceremonialit zyrtar dhe kur i kërkohet nga Drejtoria e Protokollit të Shtetit, përdor këtë procedurë prokurimi për blerjen e mallrave apo kryerjen e punëve ose shërbimeve.

4. Ngarkohen Institucioni i Presidentit të Republikës, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Kryeministria, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr. 360, datë 24.4.2013**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 170, DATË 25.4.2002 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE KUSHTEVE PËR DHËNIEN E  
LEJEVE E TË AUTORIZIMEVE PËR TREGTIMIN E NAFTËS, GAZIT E NËNPRODUKTEVE  
TË TYRE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19, 20 e 21 të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Pika 2 e kreut IV të vendimit nr. 170, datë 25.4.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Kapaciteti më i vogël i depozitave të shoqërive, që kërkojnë të pajisen me licencë tregtimi, sipas llojit të licencës, është:

a) Për licencat e tregtimit të llojit “A”, jo më pak se 500 (pesëqind) m<sup>3</sup> dhe kur kjo licencë jepet për disa kategori produktesh, depozitat për secilën kategori duhet të jenë të ndara nga njëra-tjetra.

b) Për licencat e tregtimit të llojit “A”, kategoria IV/a, kapaciteti magazinues i mbuluar të jetë me sipërfaqe, jo më të vogël se 50 (pesëdhjetë) m<sup>2</sup>.

c) Për licencat e tregtimit të llojit “B”, impiantet e depozitimit të gazit të lëngëzuar të jenë me kapacitet të instaluar, jo më pak se 100 (njëqind) m<sup>3</sup>.

ç) Për licencat e tregtimit të llojit “C”, kur:

i) licenca jepet për produkte të kategorisë II/b, jo më pak se 100 (njëqind) m<sup>3</sup>;

ii) licenca jepet për produkte të kategorisë III/c, jo më pak se 200 (dyqind) m<sup>3</sup>.

Bëjnë përjashtim nga kushti i plotësimit të kapacitetit më të vogël, sipas kësaj pike, shoqëritë anonime që kanë marrëdhënie kontraktore, sipas dispozitave ligjore në fuqi, për depozitat e karburanteve në Portin e Durrësit. Kushti i kapacitetit më të vogël i depozitave, i vendosjes në to të mjeteve matëse dhe i kalibrimit të tyre duhet të plotësohet brenda 18 (tetëmbëdhjetë) muajve pas fillimit të zbatimit të masterplanit në territorin e depozitave të karburanteve në Portin e Durrësit.”.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

#### VENDIM

Nr. 362, datë 24.4.2013

### **PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETEVE KONTRAKTUESE, PËRKATËSISHT, MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE DHE MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE TË AUTOMJETEVE NË FUND TË JETËS DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË “KURUM INTERNACIONAL”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pikat 1, 3 e 23, pika 3 shkronja “b” të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Autoritete kontraktuese për kryerjen e procedurave ligjore dhe dhënien me koncesion të menaxhimit të mbetjeve të automjeteve në fund të jetës janë: Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.

2. Miratimin e bonusit prej 7 (shtatë) pikësh për rezultatin teknik, financiar dhe mjedisor në procedurën për zgjedhëse konkurruese (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Kurum Internacional”.

3. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha



**VENDIM**  
**Nr. 20, datë 29.4.2013**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	Anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“
Admir Thanza	Anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	Anëtar i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“

me sekretare Blerina Basha, në datën 19.2.2013 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 1 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** Endri Kotherja.

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:** Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë; Avokatura e Shtetit.

**OBJEKTI:** Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, brenda një afati të arsyeshëm.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, 131/f, dhe 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Sokol Berberi, shqyrtoi dokumentet e paraqitura dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

**I**

1. Me vendimin nr. 135/6, datë 9.2.1996 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve, pranë Bashkisë Elbasan, në bazë të ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, është vendosur kompensimi në vlerë monetare i sipërfaqes prej 20.188 m<sup>2</sup>, nga një sipërfaqe totale prej 40.940 m<sup>2</sup>, në pronësi të shtetasve H.D. dhe A.D. Kërkuesi, sipas vendimit nr. 1467, datë 13.10.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, është njëri prej trashëgimtarëve ligjorë të trashëgimlënësve H.D. dhe A.D.

2. Në cilësinë e bashkëpronarit, ai i është drejtuar me shkresë, në datën 9.8.2008, Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë (AKKP), dhe ka kërkuar kompensimin në vlerë të sipërfaqes prej 20.746 m<sup>2</sup>. AKKP-ja i ka kthyer përgjigje, duke i kërkuar të plotësojë dokumentacionin e përcaktuar në aktet nënligjore përkatëse, i cili shoqëron kërkesën për kompensim, dhe ta paraqesë pranë AKKP-së kur të bëhet shpallja e datave për fillimin e procedurave dhe zbatimin e kriterëve për kompensim financiar.

3. Pas kësaj përgjigjeje, kërkuesi ka ngritur padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe ka kërkuar detyrimin e AKKP-së të nxjerrë aktin përkatës administrativ për realizimin e të drejtës së kompensimit të trullit në vlerë.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 7663, datë 29.9.2009, ka vendosur rrëzimin e padisë.

5. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1661, datë 23.9.2010, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 7663, datë 29.9.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe detyrimin e AKKP-së të

nxjerrë aktin administrativ për kompensimin në vlerë të truallit. Pas dhënies së këtij vendimi, të formës së prerë, kërkuesi i është drejtuar AKKP-së, si autoriteti kompetent për ta zbatuar atë.

6. AKKP-ja, në përgjigjen e saj, ka sqaruar se “nuk mund të procedojë pa u miratuar VKM-ja përkatëse, ku përcaktohen rregullat dhe kriteret e shpërndarjes së fondit të kompensimit, si dhe fondi përkatës që i vihet në dispozicion AKKP-së për realizimin e këtij procesi” (shkresa nr. 3511/1 Prot., datë 16.10.2012). Mbi bazën e kësaj shkrese, sipas AKKP-së, kërkuesi mund të aplikojë për kompensimin në vlerë vetëm pas miratimit të kësaj VKM-je.

7. Në këto kushte, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, nr. 1661, datë 23.9.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

8. **Subjekti i interesuar**, AKKP-ja, ka parashtruar me shkrim prapësimet si vijon:

8.1 Kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë kërkesë për kompensim brenda afateve të përcaktuara me VKM brenda vitit kalendarik përkatës dhe, për pasojë, AKKP-ja nuk mund të shprehej kryesisht me vendim përfundimtar;

8.2 Me vendimin nr. 1661, datë 23.9.2010, Gjykata e Apelit Tiranë nuk është shprehur për detyrimin e AKKP-së të kryejë kompensimin e pronës së njohur me vendimin e KKKP-së Elbasan, ndaj pretendimi i kërkuesit se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, është i pambështetur.

9. **Subjekti tjetër i interesuar**, Avokatura e Shtetit, ka paraqitur me shkrim prapësimet e mëposhtme:

9.1 Kërkuesi nuk i ka shteruar mjetet ligjore përpara se t'i drejtohej Gjykatës, sepse kundër vendimit nr. 1661, datë 23.9.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë nga ana e AKKP-së, i cili nuk është shqyrtuar ende.

9.2 Në lidhje me procesin e kompensimit të pronës, ligji parashikon rregullimin me akte nënligjore, nga Këshilli i Ministrave, të procedurave dhe kriterëve që duhet të zbatojë AKKP-ja për shpërndarjen e Fondit të Kompensimit pronarëve në të holla. Për këtë qëllim Këshilli i Ministrave ka nxjerrë VKM-në nr. 192, datë 9.3.2011, por kërkuesi nuk ka paraqitur kërkesë për kompensim pranë AKKP-së, brenda afateve të përcaktuara në këtë VKM, ndaj dhe AKKP-ja nuk mund të shprehej a priori me vendim përfundimtar.

## II

### VLERËSIMI I GJYKATËS

*Për pretendimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës*

10. Kërkuesi pretendon se vendimi i formës së prerë, nr. 1661, datë 23.9.2010, i Gjykatës së Apelit Tiranë nuk është ekzekutuar brenda një afati të arsyeshëm dhe, për këtë arsye, atij i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor.

11. Gjykata është shprehur edhe më parë në jurisprudencën e saj se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi të formës së prerë të gjykatës, është pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të Kushtetutës dhe të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Në këtë fazë duhet të marrin pjesë aktivisht jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Roli i këtyre organeve bëhet vendimtar, kur debitori refuzon të ekzekutojë vullnetarisht detyrimin e tij kundrejt kreditorit. Në raste të tilla, procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave për rastin konkret, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Pa dyshim që një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (shih



vendimet nr. 4, datë 20.2.2013; nr. 1, datë 20.1.2012; nr. 2, datë 1.2.2011; nr. 35, datë 27.10.2010 të Gjykatës Kushtetuese).

12. Në vendimmarrjen e saj Gjykata ka pranuar se: "...parimet kushtetuese lidhur me procesin e rregullt ligjor, për të cilin bën fjalë neni 42/2 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, të parashikuara në nenin 142/3 të Kushtetutës, nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pakufi për realizimin e saj". Më tej, Gjykata ka pohuar se "...ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë (...) Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre" (*shih vendimet nr. 4, datë 20.2.2013; nr. 6, datë 6.3.2009; nr. 1, datë 19.1.2009; nr. 43, datë 19.12.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Gjykata ka rikonfirmuar qëndrimin se, në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces. Kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuesit, si dhe sjelljen e autoriteteve përkatëse (*shih vendimet nr. 4, datë 20.2.2013; nr. 10, datë 1.3.2012; nr. 21, datë 3.6.2011; nr. 14, datë 15.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Çështja konkrete është vlerësuar në vijim nga Gjykata në vështrim të respektimit të standardeve të mësipërme.

15. Në lidhje me kompleksitetin e çështjes, Gjykata ka pohuar vazhdimisht se, për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimet nr. 7, datë 27.2.2012; nr. 50, datë 22.11.2011; nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 8, datë 23.3.2010; nr. 9, datë 1.4.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Çështja në shqyrtim ka për objekt mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm, për sa i përket nxjerrjes së një vendimi administrativ nga ana e AKKP-së për kompensimin në vlerë të truallit. Duke iu referuar materialeve shkresore, Gjykata konstaton se çështja konkrete nuk paraqet kompleksitet nga pikëpamja faktike ose ligjore, çka mund të justifikonte vonesat apo sjelljen mosvepruese të AKKP-së.

17. Gjykata, në jurisprudencën e saj, është shprehur se vlerësimi i sjelljes dhe i interesit të kërkuesit është një element tjetër përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve (*shih vendimet nr 50 datë 22.11.2011 dhe nr. 14, datë 15.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në rastin konkret, nga aktet shkresore rezulton se kërkuesi fillimisht i është drejtuar me shkresë AKKP-së në datën 9.8.2008, duke kërkuar kompensimin në vlerë të truallit. AKKP-ja i ka kërkuar, me shkresën nr. 1608/1 Prot., datë 1.9.2008, të plotësojë dokumentacionin e përcaktuar në aktet nënligjore përkatëse, i cili shoqëron kërkesën për kompensim dhe ta paraqesë pranë saj. Kërkuesi ka zgjedhur rrugën gjyqësore dhe i është drejtuar me padi gjykatës. Pas shpalljes së vendimit nr. 1661, datë 23.9.2010, të Gjykatës së Apelit Tiranë, sipas të cilit AKKP-ja duhej të merrte vendim mbi kërkesën e kërkuesit duke nxjerrë aktin administrativ përkatës, ai i është drejtuar sërish AKKP-së me shkresën nr. 1334 Prot., datë 21.4.2011, dhe i ka kërkuar të zbatojë vendimin gjyqësor. Gjatë kësaj kohe kërkuesi nuk ka aplikuar për kompensim pranë AKKP-së mbi bazën e VKM-së nr. 192, datë 9.3.2011, të miratuar nga Këshilli i Ministrave. Më pas, në datën 25.9.2012, ai i është drejtuar Ministrit të Drejtësisë duke i kërkuar të ushtrojë kompetencat e tij, sipas kuadrit ligjor përkatës, lidhur me realizimin e detyrimit të kompensimit në vlerë të truallit. AKKP-ja, në përgjigjen e saj nr. 3511/1 Prot., datë 16.10.2012, e ka sqaruar kërkuesin se ai mund të paraqitet pranë zyrave të AKKP-së për të aplikuar për fillimin e procedurave të kompensimit mbas miratimit të VKM-së që përcakton rregullat dhe kriteret e shpërndarjes së kompensimit për vitin përkatës. Nga aktet e shqyrtuara, Gjykata konstaton se kërkuesi, edhe pas miratimit të VKM-së nr. 768, datë 7.11.2012 "Për përcaktimin e rregullave dhe të kriterëve për shpërndarjen e fondit të kompensimit pronarëve, në të holla, për vitin 2012", nuk ka aplikuar pranë



AKKP-së për fillimin e procedurës së kompensimit, e cila mundëson realizimin e kompensimit në vlerë të truallit në pronësi.

19. Për sa i përket sjelljes së autoriteteve, Gjykata ka theksuar se përballë detyrimit për zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të gjitha subjektet, qofshin këto private apo publike, duhet të përgjigjen njëjloj (*shih vendimet nr. 7, datë 27.2.2012; nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 23, datë 17.5.2010 dhe nr. 1, datë 19.1.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Çështja në shqyrtim ka të bëjë me detyrimin e AKKP-së për të nxjerrë aktin administrativ, në lidhje me kërkesën për kompensim të kërkuarit, në zbatim të vendimit nr. 1661, datë 23.9.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

21. Në bazë të ligjit nr. 10 239, datë 25.2.2010 “Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave”, fondi i kompensimit të pronave vlerësohet fond special, që administrohet nga AKKP-ja. Procedurat e propozimit dhe të miratimit të buxhetit të këtij fondi janë po ato që zbatohen për ligjin për Buxhetin e Shtetit dhe paraqiten së bashku me të për miratim në Kuvend. Subjektet e shpronësuara, të cilave u është njohur e drejta për kompensim, në përputhje me ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, përfitojnë kompensim, nga fondi i kompensimit, në masën dhe sipas mënyrës së përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Pikërisht këtij vendimi i është referuar AKKP-ja kur ka sqaruar kërkuarin se nuk mund të procedojë pa u miratuar VKM-ja përkatëse, ku përcaktohen rregullat dhe kriteret e shpërndarjes së fondit të kompensimit, si dhe fondi përkatës që i vihet në dispozicion AKKP-së për realizimin e këtij procesi (shkresa nr. 3511/1 Prot., datë 16.10.2012). Në datën 7.11.2012, Këshilli i Ministrave ka miratuar VKM-në nr. 768 “Për përcaktimin e rregullave dhe të kriterëve për shpërndarjen e fondit të kompensimit pronarëve, në të holla, për vitin 2012”, e cila ka hyrë në fuqi në datën 21.11.2012.

22. Në vlerësimin e Gjykatës, pavarësisht se kërkuari i është drejtuar asaj përpara datës 21.11.2012, kur ka hyrë në fuqi akti nënligjor që përcakton rregullat dhe kriteret e shpërndarjes së fondit të kompensimit, ai kishte mundësi të aplikonte pranë AKKP-së për kompensim brenda afateve të përcaktuara në VKM-në nr. 768, datë 7.11.2012 (pikat 6 dhe 8), gjë të cilën nuk rezultoi që ta ketë bërë. Për më tepër, detyrimi i AKKP-së për të nxjerrë aktin administrativ, në zbatim të vendimit nr. 1661, datë 23.9.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë, përbën një aspekt formal të procesit dhe jo një vendim përfundimtar që lidhet drejtpërdrejt me kompensimin e pronës. Rrjedhimisht, mosnxjerrja e aktit administrativ nga AKKP-ja nuk e pengon kërkuarin të realizojë të drejtën materiale të kompensimit të pronës, nëpërmjet aplikimit dhe plotësimit të dokumentacionit përkatës të parashikuar nga kuadri ligjor në fuqi.

23. Nisur nga sa më lart, Gjykata arrin në përfundimin se vetë kërkuari, me sjelljen dhe veprimet e tij, ka shkaktuar vonesa në realizimin e të drejtës për kompensim të pronës, ndaj pretendimet, në drejtim të cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, nuk janë të bazuara.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/g të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

#### VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha.  
Anëtarë kundër: Bashkim Dedja (kryetar), Admir Thanza, Sokol Berberi.



## MENDIM PAKICE

Për arsye se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën, lidhur me përfundimin e arritur në këtë çështje dhe argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, e çmojmë të rëndësishme të dalim me mendim pakice.

Nëpërmjet arsytimit të saj, shumica ka konkluduar se sjellja mosvepruese e kërkuarit ka shkaktuar vonesa në realizimin e të drejtës për kompensim të pronës, ndaj pretendimet e tij, në drejtim të cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, nuk janë të bazuara.

Çështja konkrete ka për objekt mosekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, në kuadrin e të drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Siç ka nënvizuar shumica dhe si ka vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme Gjykata, ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës është konsideruar si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht, sepse vetëm pas realizimit të saj mund të konsiderohet se individit e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar (shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 10, datë 1.3.2012; nr. 21, datë 3.6.2011; nr. 6, datë 4.3.2010).

Kërkuari, në thelb, kërkon të realizojë të drejtën materiale të kompensimit të pronës dhe i është drejtuar gjykatës në funksion të realizimit të kësaj të drejte. Sipas vendimit nr. 1661, datë 23.9.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë, AKKP-ja duhet të nxjerrë aktin administrativ në lidhje me kërkesën për kompensim të bërë pranë saj nga kërkuari. Gjykata e Lartë, në dhomë këshillimi, ka vendosur mospranimin e rekursit ndaj këtij vendimi (vendim nr. 00-2013 – 225, datë 7.2.2013). Ndryshe nga shumica, mendojmë se sjellja e kërkuarit nuk ka shkaktuar vonesa në realizimin e të drejtës për kompensim të pronës dhe nuk ka penguar ekzekutimin e vendimit të formës së prerë, i cili është marrë pikërisht për vendosjen në vend të së drejtës së kompensimit. Kërkuari, në bazë të vendimit nr. 135/6, datë 9.2.1996 të KKKP-së Elbasan, gëzon të drejtën e kompensimit të pronës dhe në këtë cilësi, në datën 9.8.2008, i është drejtuar AKKP-së, si organ kompetent për realizimin e kompensimit. AKKP-ja i ka kërkuar, me shkresën nr. 1608/1 Prot., datë 1.9.2008, të plotësojë dokumentacionin e përcaktuar në VKM-në përkatëse, i cili shoqëron kërkesën për kompensim, dhe ta paraqesë pranë saj. Në momentin kur kërkuari ka paraqitur kërkesën pranë AKKP-së (9.8.2008), Këshilli i Ministrave e kishte nxjerrë vendimin përkatës për miratimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit të pronarëve në të holla, për vitin 2008 (VKM nr. 1343, datë 4.6.2008; botuar në Fletoren Zyrtare nr. 158 të datës 18.10.2008). Megjithatë kjo VKM nuk kishte hyrë ende në fuqi, AKKP-ja kishte mundësi të realizonte të drejtën e kompensimit në bazë të kuadrit ligjor në fuqi, përkatësisht, ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar<sup>1</sup>, dhe VKM-së nr. 139, datë 13.2.2008, që përcaktonte hartën e vlerës së trojeve dhe çmimet përkatëse. Sipas nenit 16 të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004, të ndryshuar, zyra e AKKP-së bën shqyrtimin fillestar të kërkesës së subjektit të shpronësuar për kompensim dhe Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, në zbatim të përgjegjësive të veta për kompensimin, shprehet me vendim. Vendimi duhet të jetë në formë të shkruar, të arsyetuar, të nënshkruar nga titullari dhe të përmbushë kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative për aktin administrativ. AKKP-ja, në rastin konkret, nuk është shprehur me vendim, por i ka kthyer përgjigje kërkuarit, duke i kërkuar të plotësojë dokumentacionin e përcaktuar në një akt nënligjor që ende nuk kishte hyrë në fuqi. Kjo përgjigje e AKKP-së është e paqartë dhe nuk i plotëson garancitë dhe parashikueshmërinë në zbatimin e së drejtës dhe sistemit normativ, që kërkon parimi i sigurisë juridike. Procesi i kthimit dhe kompensimit duhet të krijojë përshtypjen te subjektet e së drejtës se institucionet përgjegjëse do t'i përmbahen normave juridike në fuqi duke garantuar, me vendimmarrjen e tyre, siguri dhe qëndrueshmëri për të ardhmen. Pasoja e parashikueshme për kërkuarin, i cili është subjekt i ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronës në dispozita të veçanta të tij, është marrja e vendimit, sipas ligjit, nga ana e AKKP-së, gjë të cilën kjo e fundit nuk e ka bërë. Ndaj, ndryshe nga

<sup>1</sup>Ndryshuar me ligjin nr. 9583, datë 17.7.2006 dhe ligjin nr. 9898, datë 10.4.2008.

shumica, çojmë se AKKP-ja, e cila ka rolin kryesor në këtë proces, duke mos nxjerrë aktin administrativ përkatës, në përputhje me vendimin gjyqësor të formës së prerë, ka penguar realizimin e të drejtës për kompensim të kërkuarit.

Sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, së cilës i referohet Gjykata në vendimin e saj nr. 12, datë 5.3.2012, efekti i nenit 13 të Konventës kërkon parashikimin e një mjeti juridik të brendshëm për të trajtuar themelin e një “ankese të pranueshme” në bazë të Konventës dhe për të dhënë një kompensim të përshtatshëm (*shih Gjyli kundër Shqipërisë, datë 7.12.2010, par. 53*). Mjetet në dispozicion të një ndërgjyqësi për të parashtruar një ankesë për zgjatjen e procesit janë “efektive”, në qoftë se ato “parandalojnë shkeljen e pretenduar apo pengojnë vazhdimin e saj, apo ofrojnë një riparim të përshtatshëm për çdo shkelje që tashmë ka ndodhur” (*shih Scordino kundër Italisë, nr. 1, datë 29.3.2006, par. 183, 186, i cituar në vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Gjonboçari kundër Shqipërisë, datë 23.10.2007, par. 75 e 76*). Në rastet që kanë të bëjnë me moszbatimin e vendimeve të formës së prerë, çdo mjet i brendshëm për të parandaluar një shkelje, duke siguruar zbatimin në kohë ka, në parim, një vlerë të madhe. Megjithatë, kur një vendim përfundimtar është dhënë në favor të një individi ndaj shtetit, individi nuk duhet, si rregull, të jetë i detyruar të hapë procedurë të veçantë për zbatimin e vendimit (*shih Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë, datë 17.12.2012, par. 71; Metaxas kundër Greqisë, datë 27.5.2004*).

Në çështjen në shqyrtim, nga aktet shkresore, del qartë se kërkuari i ka përmbushur të gjitha detyrimet procedurale që i takonin atij dhe i ka ezauruar të gjitha mjetet ligjore që legjislacioni shqiptar i ka vënë në dispozicion. Ai nuk disponon mjet tjetër efektiv për të realizuar të drejtën e kompensimit, duke pasur parasysh se sistemi juridik shqiptar nuk parashikon ndonjë mjet juridik të veçantë për të përshpejtuar procesin, me qëllim parandalimin e te zgjatjes dhe zvarritjes së tij dhe as për kompensimin e vonesave që do të riparonte shkeljet *a posteriori*. Këtë qëndrim ka mbajtur edhe GJEDNJ-ja, në çështjen Manushaqe Puto, cituar më lart, ku ka shqyrtuar nëse janë marrë masa zbatuese, nga shteti shqiptar, për dhënien e kompensimit të pronës në një nga format e kompensimit të parashikuara nga ligji dhe nëse këto masa mund të konsiderohen si një mjet efektiv, në kuptim të nenit 13 të Konventës. Pasi ka analizuar format e kompensimit, GJEDNJ-ja ka arritur në konkluzionin se “legjislacioni vendas nuk ofron asnjë mjet efektiv, i cili lejon dëmshpërblim adekuat dhe të mjaftueshëm për shkak të moszbatimit të vendimeve të Komisionit (*kupto: KKKP*) që caktonin kompensim. Kjo nuk është në përputhje me nenin 13 të Konventës” (par. 84).

Duke vazhduar më tej, në të njëjtën çështje, GJEDNJ-ja ka konstatuar shkelje të neneve 6 § 1 dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës. Ajo është shprehur se: “ çdo aplikant gëzon të drejtën që një vendim përfundimtar në favor të tij të zbatohet (*shih Hornsby kundër Greqisë, datë 19 mars 1997*) .... faktorët e paraqitur nga Qeveria nënvizojnë dështimin për të vepruar dhe masat e vonuara të autoriteteve në çështjen konkrete për të adresuar zbatimin e vendimeve të Komisionit. ... Duke shqyrtuar materialet e paraqitura, Gjykata nuk sheh arsye për të ndryshuar qëndrimin e saj në rastet e mëparshme (*Ramadhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë, datë 13.11.2007; Hamzaraj kundër Shqipërisë, datë 3.2.2009; dhe Nuri kundër Shqipërisë, datë 3 shkurt 2009*)” (par. 97).

Duke pasur parasysh standardet e mësipërme të vendosura nga GJEDNJ-ja, si dhe në vështrim të fakteve të çështjes konkrete, vlerësojmë se mosekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë, në kushtet e mospasjes së një mjeti tjetër efektiv, e ka penguar kërkuarin të realizojë të drejtën e pronës. Për pasojë, Gjykata duhet të kishte vendosur pranimin e kërkesës dhe konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe neneve 6 dhe 13 të KEDNJ-së.

Anëtarë: Bashkim Dedja, Sokol Berberi.



**VENDIM**  
**Nr.21, datë 29.4.2013**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	Anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“
Admir Thanza	Anëtar i	“	“
Altina Xhoxha	Anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	Anëtar i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“

me sekretare Blerina Basha, në datën 16.1.2013 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore mbi bazë dokumentesh çështjen nr. 2 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** Geg Pepkolaj

**SUBJEKT I INTERESUAR:** Prokuroria e Përgjithshme

**OBJEKTI:** Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimit nr. 2476, datë 14.5.2009 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë; i vendimeve gjyqësore: nr. 1403, datë 3.12.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 530, datë 30.6.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 937, datë 29.10.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, 131/f, 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoji relatoren e çështjes, Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuessit, që kërkoi pranimin e kërkesës dhe, pasi bisedoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

**I**

1. Kërkuesi, në vitin 1996, ka blerë një autobus të cilin e ka përdorur si mjet transporti në linjën Kamëz-Tiranë. Duke qenë se biznesi nuk ishte më fitimprurës, kërkuesi ka vendosur ta mbyllë autobusin dhe ka rënë dakord gojarisht me shtetasin B.C., të cilin e njihte nga viti 1984, që ta linte te shtëpia private e këtij të fundit. Kërkuesi ka marrë dijeni se shtetasi B.C. e kishte shitur autobusin për skrap, fakt që mohohet nga ky i fundit. Në kushtet e mosmarrëveshjes me shtetasin B.C., kërkuesi, duke pretenduar se është mashtruar, i është drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke kërkuar fillimin e ndjekjes penale për veprën penale të “mashtrimit”, parashikuar nga neni 143/1 i Kodit Penal (KP).

2. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e datës 22.6.2009, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. 2476, datë 14.5.2009, me arsyetimin se: “*nuk ka asnjë provë që të vërtetojë faktin që shtetasi B.C. të ketë mashtruar kërkuesin. Për rrjedhojë, këto mbeten vetëm pretendime të kallëzuesit, pasi në veprimet dhe mosveprimet e shtetasit B.C. nuk konstatohen elemente të ndonjë vepre penale*”.

3. Kërkuesi e ka kundërshtuar vendimin e prokurorit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, me vendimin nr. 1403, datë 33.12.2009, ka vendosur rrëzimin e kërkesës.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 530, datë 30.6.2010, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, me vendimin nr. 937, datë 29.10.2010, bazuar në nenin 433 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), ka vendosur mospranimin e rekursit, për arsye se ai nuk përmban nënshkrimin e mbrojtësit, sipas nenit 435/2 të KPP-së.

## II

6. Kërkuesi, në datën 25.9.2012, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e vendimeve objekt shqyrtimi, duke pretenduar, në thelb se:

6.1 Është mohuar e drejta për t'u ballafaquar me të akuzuarin për veprën penale të mashtrimit, për shkak të mosparaqitjes përpara organit procedues.

6.2 Është cenuar e drejta e aksesit në Gjykatën e Lartë, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur, në dhomë këshillimi, mospranimin e rekursit për shkak se nuk përmban nënshkrimin e mbrojtësit.

7. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, nuk ka paraqitur me shkrim parashtrime në lidhje me çështjen, objekt i këtij shqyrtimi.

## III

### A. Për legjitimitimin e kërkuesit

8. Gjykata, paraprakisht, vlerëson se pretendimet e parashtruara nga kërkuesi duhet të analizohen nën dritën e standardeve që përkufizojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor në drejtim të garantimit të aksesit në Gjykatën e Lartë, pasi në kërkesë mungojnë argumentet mbi proceset gjyqësore penale në dy shkallët e tjera të gjykimit.

9. Në këtë kuptim, Gjykata çmon se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të rregullimit kushtetues të neneve 131/f dhe 134/g të Kushtetutës, vetëm për pretendimet që kanë lidhje me procesin gjyqësor penal të zhvilluar në Gjykatën e Lartë; *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit të parashikuar nga neni 30, pika 2 e ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", si dhe *ratione materiae*, pasi shqyrtimi i pretendimit se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i ka mohuar atij të drejtën e aksesit në gjykatë, duke mos pranuar rekursin për arsye të mungesës së nënshkrimit të mbrojtësit, është në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

### B. Për pretendimin për cenimin e të drejtës për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë (e drejta e aksesit)

10. Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, se mospranimi nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, i rekursit të panëshkruar nga mbrojtësi, i ka cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë. Sipas tij, mungesa e nënshkrimit të mbrojtësit nuk mund të sjellë detyrimisht mohimin e të drejtës për t'iu dëgjuar dhe për të marrë përgjigje mbi shkaqet e ngritura në recurs.

11. Në jurisprudencën e saj gjykata është shprehur se e drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një nga elementet më të rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ). Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në këtë këndvështrim, Gjykata ka theksuar se e drejta për t'iu drejtuar gjykatës përbën një garanci për administrimin e mirë të drejtësisë prandaj, çdo interpretim i ngushtë i nenit 42 të Kushtetutës dhe i nenit 6 të KEDNJ-së nuk përputhet me qëllimet dhe objektin e këtyre dispozitave (shih vendimet nr. 14, datë 3.6.2009; nr. 41, datë 28.9.2011 të Gjykatës Kushtetuese).

12. Gjykata ka vlerësuar se neni 435/2 i Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon se "*rekursi dhe memoriet që i drejtohen Gjykatës së Lartë duhet të nënshkruhen nga mbrojtësit e të pandehurve*", ka për qëllim të garantojë mbrojtjen me avokat të të pandehurit, në rastin kur ai ushtron recurs. Standardi i mbrojtjes me avokat në Gjykatën e Lartë nuk garantohej plotësisht nëse respektohet vetëm gjatë shqyrtimit gjyqësor. Recursi është akti procedural në të cilin parashtrihen shkaqet për të cilat kundërshtohet një vendim sipas kërkesave të nenit 432 të KPP-së, që mundëson të drejtën e të pandehurit për të filluar gjykimin në Gjykatën e Lartë dhe, në këtë kuptim, ai është akti me të cilin garantohej e drejta për akses në këtë gjykatë. Kërkesa kushtetuese dhe procedurale për të garantuar mbrojtjen efektive dhe profesionale të të pandehurit në Gjykatën e Lartë, ka kuptim, para së gjithash, në funksion të aksesit që duhet të kenë të pandehurit për të ushtruar të drejtat që parashikon procedura penale. Qëllimin e



ligjvënësit, për të garantuar mbrojtës në këtë proces, e shpreh edhe detyrimi që kjo normë i ngarkon kryetarit të kolegjit, për të caktuar një mbrojtës kryesisht për të pandehurin, i cili nuk ka mbrojtës të zgjedhur (shih vendimin nr. 8, datë 28.2.2012 të Gjykatës Kushtetuese).

13. Po ashtu, Gjykata është shprehur se përdorimi i mjetit procedural të përshtatshëm ankimes, në formë e në përmbajtje, siç është sanksionuar në KPP, nuk përbën një kërkesë formale, por një kërkesë që lidhet me thelbin e të drejtës së mbrojtjes dhe të pjesëmarrjes aktive në gjykim. Shqyrtimi i mjetit procedural në mënyrë josubstanciale cenon të drejtën e aksesit në Gjykatën e Lartë, pasi gjykimi në atë gjykatë, në dallim nga procedurat e gjykimit që zhvillohen në gjykatat e zakonshme, ka si veçori paraqitjen vetëm të argumenteve ligjore. Kompleksiteti i procedurave të gjykimit në Gjykatën e Lartë konfirmohet edhe nga dispozitat ligjore që sanksionojnë se palët duhet të përfaqësohen në këtë gjykim nga avokati. Prandaj, shqyrtimi nga Gjykata e Lartë kryesisht i çështjeve të ligjit, jo vetëm që e justifikon plotësisht përfaqësimin me avokat në seancat dëgjimore, por për më tepër, bëhet i domosdoshëm për garantimin në favor të të pandehurit të një mbrojtjeje efektive dhe profesionale (shih vendimin nr. 5, datë 4.3.2008; nr. 41, datë 28.9.2011 të Gjykatës Kushtetuese).

14. Për të garantuar të drejtën e një individi për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë, zbatimi i nenit 435/2 të KPP-së duhet parë në raport me rregullimet e përgjithshme që dispijnojnë paraqitjen e ankimit (nenet 407-421 të KPP-së), si dhe ato të veçanta për paraqitjen e rekursit (nenet 431-435 të KPP-së). Në situatën në të cilën kërkuesi ka ushtruar rekursin, në përmbushje të detyrimeve të tij formale që përcaktohen kryesisht në nenet 410, 412, 420, 435/1 të KPP-së, dhe rekursi nuk është nënshkruar nga mbrojtësi i zgjedhur prej tij, ai nuk mund të privohet nga e drejta që rekursi i tij të vlerësohet sipas përcaktimeve të nenit 432 të KPP-së. Në këtë vështrim, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë, para se të vendosë mospranimin e rekursit për shkak të mosnënshkrimit të tij nga mbrojtësi, duhet të verifikojë nëse sekretaria gjyqësore ka zbatuar detyrimin ligjor për vënien në dijeni të të pandehurit, për të plotësuar rekursin me nënshkrimin nga mbrojtësi, sipas kuptimit që Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin unifikues nr. 5, datë 15.9.2009, i kanë dhënë nenit 415/2 të KPP-së. Këto kërkesa ligjore kanë rëndësi kushtetuese, sepse garantojnë realisht të drejtën e individit për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë (shih vendimin nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese).

15. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se kërkuesi, i cili nuk ka qenë i pandehur në procesin gjyqësor penal objekt kundërshtimi, ka depozituar brenda afatit ligjor, pranë sekretarisë së gjykatës që ka dhënë vendimin, një rekurs i cili nuk ka qenë i nënshkruar nga mbrojtësi i tij. Kolegji Penal ka vendosur mospranimin e rekursit, në dhomë këshillimi, për shkak se rekursi i paraqitur nga kërkuesi nuk përmbante nënshkrimin e mbrojtësit, sipas kërkesave të nenit 435/2 të KPP-së. Nga materialet e paraqitura para Gjykatës Kushtetuese nuk rezultojnë që Kolegji Penal të ketë vlerësuar detyrimin e sekretarisë gjyqësore përkatëse dhe veprimet e saj për plotësimin e kërkesës formale për nënshkrimin e rekursit nga mbrojtësi i kërkuesit.

16. Gjykata vlerëson se, në vështrim të kufijve të zbatimit të nenit 435/2 të KPP-së, të cilët në mënyrë të vazhdueshme janë përkufizuar nga jurisprudenca kushtetuese si mjeti procedural për garantimin e aksesit në gjykatë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka interpretuar nenin 435/2 të KPP-së në mënyrë të ngushtë, joharmonike dhe të shkëputur nga fryma e Kushtetutës dhe ajo e kuadrit ligjor procedural penal.

17. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), duke vendosur mospranimin e shqyrtimit të rekursit të paraqitur nga kërkuesi, me arsyetimin se nuk ka qenë i nënshkruar nga mbrojtësi, i ka cenuar kërkuesit të drejtën e aksesit në Gjykatën e Lartë, si një nga standardet për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës; neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash:

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
  - Shfuqizimin e vendimit nr. 937, datë 29.10.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).
  - Kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.
- Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Admir Thanza, Sokol Berberi, Fatmir Hoxha.
- Anëtarë kundër: Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha.

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-eksponitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

Hyri në shtyp më 9.5.2013  
Doli nga shtypi më 9.5.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2013

Çmimi 32 lekë